



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1863, datë 10.04.2012

Për

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa me nr. 8738Prot., datë 30.12.2011 (nr. 1986Prot., i AKEP, datë 30.12.2011) të depozituar nga Abissnet sh.a., “Për zgjidhje të mosmarrëveshjes lidhur me Draft-Marrëveshjen për akses dhe interkoneksion midis shoqërisë Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”;
- Shkresa e Abissnet sh.a., me nr. 7743Prot., datë 22.11.2011, “Për realizimin e marrëveshjes së interkoneksionit me Eagle Mobile sh.a.”;
- Shkresa e Eagle Mobile sh.a., me nr. 4122Prot., datë 9.12.2011, “Kthim përgjigje shkresës nr. 7743Prot., datë 22.11.2011, “Për realizimin e marrëveshjes së interkoneksionit me Eagle Mobile sh.a.”;
- Procesverbal i datë 10.2.2012, i mbajtur gjatë seancës paraprake mes Abisnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.;
- Email i datës 19.3.2012, i Eagle Mobile për informacion në AKEP.
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe,
duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

- I. Sipërmarrësi Abissnet sh.a., me shkresën nr. nr. 8738Prot., datë 30.12.2011 (nr. 1986Prot., i AKEP, datë 30.12.2011) të depozituar nga Abissnet sh.a., “Për zgjidhje të mosmarrëveshjes lidhur me Draft-Marrëveshjen për akses dhe interkoneksion midis shoqërisë Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”, sqaron se:
 1. Përpjekjet për lidhur marrëveshjen e interkoneksionit mes Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a., kanë nisur që me kërkesën e datë 28.9.2011.
 2. Abissnet me shkresën nr. 7743Prot., datë 22.11.2011, “Për realizimin e marrëveshjes së interkoneksionit me Eagle Mobile sh.a. (EM)” bën me dije se në draft marrëveshjen e

dërguar nga EM, në Aneksin II, pika 2.4, “Tarifa e shërbimeve të interkoneksionit” për shërbimin 001-Tarifa e instalimit për çdo sistem 2 Mbit/s, është përcaktuar në vlerën 136 000 Lekë. Kjo tarifë nuk është përcaktuar në RIO e EM dhe Abissnet sh.a. do të ndërtojë qarkun E1, që bën të mundur lidhjen e interkoneksionit, duke përballuar të gjithë koston e nevojshme për procesin e ndërtimit e instalimit të këtij qarku.

3. Gjithashtu, në draft MI të EM në Aneksin III, pika 3.7, “Sanksionet” parashikohet që: “... në rast se pala debitore vonon pagesën e shumës neto pas balancimit, siç është përcaktuar në këtë Aneks të MI, atëherë do të detyrohet të paguajë kamatvonesë në masën 0.5%, të vlerës së shumës së detyruar për çdo ditë kalendarike”. Vlera e kamatvonesës që kërkon të aplikojë EM është 15 herë më e lartë se interesat bankare që zbatojnë bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë (interesi i tyre shkon 7-10% në vit).
 4. Kjo klauzolë e marrëveshjes është papranueshme nga Abissnet sh.a. për arsyet e sipërpërmendura. Kjo bie në kundërshtim me Vendimin Unifikues nr. 932, datë 22.6.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
 5. Eagle Mobile sh.a. me shkresën nr. 4122Prot., datë 9.12.2011, “Kthim përgjigje shkresës nr. 7743Prot., datë 22.11.2011, “Për realizimin e marrëveshjes së interkoneksionit me Eagle Mobile sh.a.” informon Abissnet sh.a. se:
 6. Në RIO e publikuar është përcaktuar tarifa e instalimit 136 000 Lekë për çdo sistem 2 Mbit/s, shumë e cila paguhet vetëm njëherë. EM bën me dije se kjo tarifë është aplikuar për të gjithë operatorët alternativë.
 7. Sa i takon vlerës së kamatvonesës prej 0.5% dhe afateve kohore të pagesës, Eagle Mobile sh.a., sqaron se janë kushte të përcaktuara në ORI dhe të detyrueshme për t’u zbatuar.
 8. Eagle Mobil sh.a. në zbatim të kuadrit rregullator ne fuqi, mirëpret draft MI nga Abissnet sh.a., për të vijuar procedimin e zgjidhjes teknike e firmosjes së saj.
 9. Abissnet sh.a., gjendur përpara kësaj situate të pafavorshme, duke qënë të interesuar për lidhjen e interkoneksionit me EM, kërkon nga AKEP të shqyrtojë mosmarrëveshjen e shpjeguar me lart, dh etë ndërhyjë për të bërë ndryshimet e nevojshme tek RIO dhe tek draft marrëveshja e interkoneksionit e EM, në mënyrë që të mos aplikohet zbatimi i tyre.
- II. Më datë 10.2.2012, në ambientet e AKEP, u zhvillua takimi mes palëve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a. Çështja kryesore e diskutuar, tarifa e instalimit prej 136 000 lekë, u kundërshtua edhe gjatë takimit nga Abissnet sh.a. Nga AKEP, palëve iu la detyrë të diskutohej rishikimi i kësaj tarife për shërbimin 107 (*Shërbimi i lidhjes fillestare të një qarku 2 Mbit/s për interkoneksionin e ndërmjetëm i cili kërkohet nga Operatori Përfitues dhe ofrohet nga EM.*).

Me postë elektronike (email) të datës 19.3.2012, të Eagle Mobile, informohemi se me datë 16.3.2012, në ambientet e Eagle Mobile është zhvilluar takim me Abissnet sh.a. Në përfundim, palët mbajtën të njëjtin qëndrim, ku Eagle Mobile sh.a. insiston në pagesën e tarifës së instalimit për sistem 2Mbit/s dhe Abissnet sh.a. e kundërshton, dhe se marrëveshja e interkoneksionit do të nënshkruhet dhe do të hyjë në forcë pasi AKEP të shprehet mbi mosmarrëveshjen e palëve.

III. Duke qënë se, sipërmarrësit Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a megjithë negociatat dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord mbi tarifën e terminimit, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Abissnes sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Jonida Gjika Kryetar
 - Përparim Buçaj Anëtar
 - Ded Jakaj Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
 - Jetmir Braha Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**